



06/01/2023

Gjirokastrë – Arrestohet 1 Shtetas, Procedohen Penalisht 3 Tjerë

Gjirokastrë

Gjuajtën shpendë në mënyrë të paligjshme, procedohen penalisht 3 shtetas.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e rasteve të gjuetisë së paligjshme, referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprën penale “Gjueti e paligjshme”, në ngarkim të shtetasve V. Sh., 66 vjeç, S. Sh., 35 vjeç dhe K. N., 46 vjeç, banues në Lushnjë.

Këta shtetas janë ndaluar nga shërbimet e Policisë, në vendin e quajtur “Kthesa e Picarit”, Gjirokastrë, pasi kishin gjuajtur shpendë, në mënyrë të paligjshme. Në automjetin me të cilin udhëtonin këta shtetas u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 3 armë gjahu me lejet përkatëse, fishekë, shpendë dhe kafshë të vrara.


Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan në flagrancë shtetasin D. M., 43 vjeç, banues në Përmet, pasi u kap në vendin e quajtur “Kthesa e Frashërit”, duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent